



This project is funded by the European Union.

Strengthening capacity in National Nature Protection preparation for Natura 2000 network



#AlbanianWetlands konkurs fotografie Kriteret e konkursit

KRITERET E KONKURSIT

Kriteret lidhen me konkursin #AlbanianWetlands #LigatineShqipërisë.

Duke marrë pjesë në këtë konkurs kandidati pranon kriteret dhe kushtet e konkursit.

Konkursi fotografik #AlbanianWetlands organizohet nga projekti "NaturAL" (Forcimi i Kapaciteteve kombëtare në mbrojtjen e Natyrës - përgatitja për rrjetin Natura 2000) në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe AKZM, si dhe AOS, INCA dhe PPNEA, shoqatat mjedisore me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e ligatinave dhe mbrojtjen e biodiversitetit në Shqipëri.

Konkursi përfshin postimin e fotos nga ligatinat në Facebook, duke përdorur me hashtag #AlbanianWetlands, #KeepWetlands dhe #IWP019 si dhe @NaturalAlbania së bashku me një shpjegim të shkurtër në gjuhët shqip ose anglisht.

Fituesit do të përzgjidhen në 3 kategoritë:

1. Shpendët e ujit
2. Ligatinat
3. Rreziqet që kërcënojnë ligatinat

RREGULLAT E PJESËMARRJES

Konkursi është i hapur për të gjithë qytetarët shqiptarë. Punonjësit e Ministrisë, AKZM-së, organizatat që e mbështesin konkursin dhe stafi i projektit nuk lejohet të marrin pjesë.

- Pjesëmarrja synon të paraqesë dhe promovojë ligatinat dhe shpendët e ujit të Shqipërisë.
- Nuk ku kufizim në lidhje me numrin e fotove të përcjella nga çdo pjesëmarrës. Fotografia mund të realizohet me aparat celular, aparat fotografik ose pajisje tjetër.
- Nuk kërkohet rregjistrim. Pjesëmarrja rregjistrohet përmes postimit të fotos në Facebook në faqen e projektit @NaturalAlbania dhe hashtag #AlbanianWetlands #KeepWetlands #IWC2019. Të gjitha postimet duhet të jenë "publike" në mënyrë që të aksesohen nga juria.
- Postimet duhet të realizohen përpara datës 27 janar 2019 12:00 CET. Të gjitha postimet pas këtij afati nuk do të meren në konsideratë. Stafi i projektit nuk mban përgjegjësi për problemet që mund të shoqërojnë postimin si pasojë e mungesës apo problemeve me internetin apo problem tjetër të mundshëm.
- Fotot duhet të realizohen përgjatë periudhës 16-27 janar 2019, në Shqipëri. Kur postoni fotot vendndodhja duhet përcaktuar.
- Fotot mund të korrektohen apo të përdoren filtra, por jo të manipulohen sa l takon kontekstit.
- Projekti ruan të drejtën të përjashtojë pjesëmarrësit që paraqesin foto me përmbajtje dhune, diskriminimi e gjithçka që mund të çënojë të drejtat e njeriut. Gjithashtu ato nuk duhet të shkelin parimin e ruajtjes së privatësisë së personave.
- Nuk lejohet: lidhja/referimi i institucioneve, partive politike apo simboleve të institucioneve, etj.



- Me postimin e fotos në Facebook dhe përdorimin e hashtag #AlbanianWetlands pjesëmarrësi në konkurs pranon që fotot e tij mund të përdoren nga stafi i projektit për qëllime komunikimi.
- Stafi i projektit do të njoftojë fituesit me rezultatet e sfidës. Nëse fituesi nuk mund të kontaktohet pas disa përpjekjeve, stafi i projektit ruan të drejtën të kontaktojë më të mirin në radhë të përzgjedhur.

PERIUDHA E PJESËMARRJES: 16-27 JANAR 2019 @ 12:00 CET.

CMIMET

Fituesit do të shpallen më 2 shkurt, ditën ndërkombëtare të ligatinave. 3 fotot e përzgjedhura do të fitojnë:

1. Udhëzuesi i plotë i Shpendëve Evropianë: Lars Svensson, Peter J. Grant, Killian Mullarney, Dan Zetterström, David A. Christie (Collins edition)
2. Udhëzuesi i Shpendëve të Shqipërisë: Dr. Stoyan Nikolov, Mirjan Topi
3. Shëtitje me udhërrëfyes dhe varkë në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta National Park ose Parkun natyror Kunë-Vain-Tale

Vizita në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta përfshin 2 persona dhe zgjat 1 orë shëtitje me varkë dhe 1 orë shëtitje me bicikletë.
Vizita në Parkun Natyror Kunë-Vain-Tale përfshin 3 persona dhe zgjat 1 orë shëtitje me varkë

PËRZGJEDHJA

Një juri e përbërë nga përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare dhe kombëtare si dhe përfaqësues të shoqërisë civile do të përzgjedhë 3 fotot më të mira.

Kriteret e vlerësimit janë (a) kreativiteti; (b) përmbajtja dhe (c) kompozicioni

Pjesëmarrësit pranojnë të gjitha KRITERET E MËSIPËRME.

Për cdo informacion na shkruani në info@natura.al

